



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTVENDIM

Nr. ____/2024

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT LIDHUR ME SHËRBIMET PUBLIKE TË STERILIZIMIT DHE TË CHECK-UP NË SHËNDETËSI

Në mbështetje të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VE NDOSI :

1. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për shërbimin publik të Sterilizimit dhe shërbimin publik të Check-up në shëndetësi.
2. Komisioni Hetimor ka për objekt të veprimtarisë së tij:
 - (i) Shqyrtimin e çështjeve të lidhura me kontratat publike për shërbimin publik të sterilizimit dhe atë të check-up në shëndetësi, si dhe zbatimin e tyre;
 - (ii) Vlerësimin e nevojës për marrjen e masave administrative apo ndërhyrje ligjore në legjislacionin përkatës.
3. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për cdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, vecanërisht parimin e ndarjes së pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve të drejtësisë, parimin për një proces të rregullt ligjor, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e paanshmërisë dhe i respektimit të jetës private të individit.
4. Komisioni Hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime për marrjen e masave me karakter administrativ dhe/ose ndryshime të nevojshme ligjore.
5. Komisioni Hetimor do të përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë, nga të cilët kryetari dhe 6 (gjashtë) anëtarë propozohen nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe 8 (tetë) anëtarë propozohen nga Grupi Parlamentar i Partisë

Socialiste si me poshtë:

1. Z. Albana Vokshi	Kryetar	PD
2. Z. Plarent Ndreca	Nënkryetar	PS
3. Znj. Klodiana Spahiu	Anëtar	PS
4. Znj. Milva Ekonomi	Anëtar	PS
5. Z. Ilirjan Pendavinji	Anëtar	PS
6. Z. Ilir Metaj	Anëtar	PS
7. Znj. Edona Bilali	Anëtar	PS
8. Z. Petro Koçi	Anëtar	PS
9. Z. Klevis Xhoxhi	Anëtar	PS
10. Znj. Zheni Gjergji	Anëtar	PD
11. Znj. Ina Zhupa	Anëtar	PD
12. Z. Edmond Spaho	Anëtar	PD
13. Z. Saimir Korreshi	Anëtar	PD
14. Z. Xhelal Mziu	Anëtar	PD
15. Z. Petrit Vasili	Anëtar	PD

Anëtarët Zëvendësues

1. Z. Lavdrim Krashi	Anëtar zëvendësues	PS
2. Znj. Mirela Pitushi	Anëtar zëvendësues	PS
3. Znj. Emilia Koliqi	Anëtar zëvendësues	PD
4. Znj. Ilda Dhori	Anëtar zëvendësues	PD

6. Komisioni Hetimor do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 4 - mujor, nga data e miratimit të këtij vendimi. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar të Komisionit, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së komisionit.
7. Ngarkohen Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni Hetimor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R J A

Lindita NIKOLLA

Miratuar në datën _____._____.2024